



## LISTA E BORXHLINJVE NR.09/2022 PËR BORXHE TË VONUARA DERI MË 31.05.2022 DHE TË PAPAGUARA DERI MË 31.08.2022

Drejtoria e të Ardhurave Publike publikon Listën e borxhlinjve nr. 09/2022 për borxhe të vonuara deri më 31.05.2022 dhe të papaguara deri më 31.08.2022 në bazë të TVSH-së, tatimit të fitimit, tatimit personal të fitimit, kontribute nga sigurimi i obligueshëm social, akciza dhe dogana, për të cilat shuma totale e borxhit është:

1. Më e lartë se 120.000 denarë për personat fizik dhe kryerësit e veprimtarive të parvarura
2. Më e lartë për 300.000 denarë për personat fizik

Lista e borxhlinjve publikohet në web faqen e Drejtorisë së të Ardhurave Publike në pajtim me nenin 9 nga [Ligji për procedurë tatimore](#).

Drejtoria e të Ardhurave Publike, pa pëlqim të obliguesit tatimor mund të publikojë në web faqen e saj të dhëna për shkak të korigjimit të informatave jo të plota të cilat janë të publikuara në Listën e borxhlinjve.

Nëse obliguesi tatimor nuk pajtohet me të dhënat e publikuara, Ju lutemi të drejtoheni der te:

- Drejtoria Regjionale e DAP e cila është kompetente (shih kontaktet) – për borxhet e publikuara në bazë të TVSH-së, tatimit të fitimit, tatimit personal dhe kontributet nga sigurimi i obligueshëm social.
- Drejtoria Doganore e RMV – Departamenti për pagesë të të ardhurave, buxhet, garanca dhe analiza (tel. 02/3293 978 apo 02/ 3293 971) – për borxhet e publikuara në bazë të akcizave, doganat dhe TVSH gjatë importit.

Në Listën e borxhlinjve nr.09/2022 të publikuar janë 1.673 borxhlinjë – persona juridik (për 4 më pak nga lista e mëparshme) dhe 2772 persona fizik (për 425 më pak nga lista e mëparshme). Borxhi total neto i publikuar në Listën nr. 09/2022 është 8.183.905.239 denarë, më shumë për 71.086.498 denarë nga lista e mëparshme. Borxhi neto për tatime dhe kontribute është 7.970.275.824 denarë, (për 61.032.278 më shumë nga lista e mëparshme), deri sa borxhi për shpenzime doganore është 213.629.415 denarë ( për 10.054.220 denarë më pak nga lista e mëparshme).